

Styria (Steiermark) vaksinon!

PSE DUHET TË VAKSINOHENI?

Vaksinimi ju mbron që të mos sëmurëni rëndë me COVID-19.

SI FUNKSIONON VAKSINIMI?

Nëpërmjet vaksinimit trupi pranon informatën që të krijoj antitrupa. Këta antitrupa e mbrojnë trupin nga të sëmurit rëndë me COVID-19. Të gjitha vaksinat nuk përmbajnë asnjë virus (SARS-CoV-2).

A ËSHTË VAKSINIMI I SIGURT?

Po. Vaksina është testuar për siguri. Agjensia Evropiane e Barnave e ka dhënë miratimin. Vaksina është gjithashtu e sigurt edhe për personat me diabet, tension të lartë, sëmundje të zemrës dhe astmë.

JU KENI ALERGJI. A MUNDENI MEGJITHATË TË VAKSINOHENI?

Punonjësitë e kujdesit shëndetsor mund t'a kalojnë me ju listën e përmbajtjes së vaksinës, për tu siguruar që mund t'a bëni vaksinimin. Vaksina COVID-19 nuk përmban vezë, xhelatinë, mjete konservuese ose antibiotikë.

JU KENI QENË I/E SËMURË ME COVID-19. A KENI AKOMA NEVOJË PËR VAKSINIM?

Po. Imuniteti pas një lëngimi nga sëmundja me COVID-19 ju mbron për një kohë të caktuar. Ju mund prapë të sëmuheni me COVID-19. Është më mirë të vaksinoheni ashtu që të mbroheni.

A KA EFEKTE ANËSORE NGA VAKSINIMI?

Mund të ketë efekte anësore: dhimbje ose skuqje në vendin e injeksionit, si dhe kokëdhembje, ethe dhe shtrëngime të muskujve. Këto reagime janë mjaft të zakonshme, por janë reagime normale. Këto reagime kalojnë në të shumtën e rasteve brenda pak ditëve. Pas vaksinimit, ju do të vëzhgoheni nga personeli mjekësor për rreth 15 minuta

A JENI I/E DETYRUAR TË VAKSINOHENI?

Jo, nuk ekziston kurrfarë detyrimi i përgjithshëm për vaksinim. Çdo person që dëshiron të vaksinohet do të marrë një ofertë për t'u vaksinuar, sipas orarit të vaksinimit.

SI DO TË MERRNI NJË TERMIN PËR VAKSINIM?

Regjistrohuni në platformën e Styrias për vaksinim në [steirischen Impfplattform](#). Posa të ju vjen rradha sipas planit/orarit të vaksinimit, do të informoheni për detajet e mëtejshme. Ju lutemi sillni me vete dokumentet e mëposhtme në takimin për vaksinim:

- Konfirmimin e regjistrimit të shtypur ose dixhital
- e-Card-ën e juaj valide
- Librezën- kartelën e juaj të vaksinimit (nëse e keni në dispozicion)
- Listën aktuale të medikamenteve (nëse ka)
- Aufklärungs- und Dokumentationsbogen zur Corona-Schutzimpfung – të plotësuar (Fletë-informacion-sqarimin dhe Pyetësorin e kompletuar për vaksinim nga Corona me vaksinë) – të plotësuar

A KENI NDONJË PYETJE LIDHUR ME VAKSINIMIN KUNDËR CORONËS DHE VAKSINËN?

Kontakttoni telefonin federal të informacionit: 0800 555 621

▶ Të gjitha informatat për Styria vaksinon „Steiermark impft“:
www.impfen.steiermark.at

▶ Regjistrimi paraprak për vaksinim:
www.steiermarkimpft.at